

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit të përqendrimit të parashtruar nga **ProFarma Grup Holandia BV**, me seli në Shipholveg 73, 2316ZL Linden Holandë, nëpërmjet avokatit Dejan Knezoiviq, Shoqëria e Avokatëve Knezoiviq dhe Bashkëpunëtorëve nga Shkupi, në seancën e mbajtur më **04.10.2023**, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet përqendrimi me të cilin **ProFarma Grup Holandia BV**, me seli në Shipholveg 73, 2316ZL Linden Holandë synon të marrë kontrollin mbi **Klinres Farmacia d.o.o.** me seli në Srebrnjak 61, Zagreb, Kroaci, **SHOQËRIA TREGTARE PËR TREGTI DHE SHËRBIME KLINRES FARMACIA SHPK BEOGRAD** me seli në Batalionin e Beogradit 4, 11030 Beograd Serbi, **Klinres Farmacija d.o.o.** me seli në Alipashina 29, Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë, **Klinres Farmacia SH.P.K.** me seli në rrugën "Xhanfizo Keko" nr. 56, Tiranë, Shqipëri, **Klinres Farmacia Bulgaria OOD.** me seli në Sofje 1712, rr. Filip Avramov nr. 17, fl. 2, zyra 307. **Kliners Farmacia** me seli në Gjeorgji, Tbilisi, rrethi Saburtalo, rr. Shartava, nr. 40, kati 10, **Klinres Farmacia S.R.L.** me seli në Bul. Dimitrie Kantemir nr. 4, Godina 3C, Hyrja A, Kati 5, Apartament 23, Sektori 4, Bukuresht, Rumani, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës më 15.09.2023, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Komisioni) është dorëzuar një njoftim i përqendrimit nga **ProFarma Grup Holandia BV**, me seli në Shipholveg 73, 2316ZL Linden Holandë, me anë të së cilit **ProFarma Grup Holandia BV** synon të marrë kontrollin mbi **Klinres Farmacia d.o.o.**

me seli në Srebrnjak 61, Zagreb, Kroaci, **SHOQËRIA TREGTARE PËR TREGTI DHE SHËRBIME KLINRES FARMACIA SHPK BEOGRAD** me seli në Batalionin e Beogradit 4, 11030 Beograd Serbi, **Klinres Farmacia d.o.o.** me seli në Alipashina 29, Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë, **Klinres Farmacia SH.P.K.** me seli në rrugën "Xhanfizo Keko" nr. 56, Tiranë, Shqipëri, **Klinres Farmacia Bulgaria OOD.** me seli në Sofje 1712, rr. Filip Avramov nr. 17, fl. 2, zyra 307. **Kliners Farmacia** me seli në Gjeorgji, Tbilisi, rrethi Saburtalo, rr. Shartava, nr. 40, kati 10, **Klinres Farmacia S.R.L.** me seli në Bul. Dimitrie Kantemir nr. 4, Godina 3C, Hyrja A, Kati 5, Apartament 23, Sektori 4, Bukuresht, Rumani (të gjithë së bashku - shoqëritë e synuara direkt"), si dhe kontrolli indirekt mbi **Klinres Farmacia D.O.O.** Zagreb, Përfaqësia në Republikën e Maqedonisë Shkup, me seli në Arso Mickov nr. 12, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe pjesë e shoqërisë së huaj "Klinres Farmacia" D.O.O – Përfaqësia Podgoricë, me seli në Bul. Shën Peter Cetinski 114/I Podgoricë, Mali i Zi (së bashku – Shoqëritë e synuara indirekte).

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Grupi ProFarma është një ofruer global, i pavarur i shërbimeve rregullatore, klinike dhe të pajtueshmërisë me një burim që u shërbejnë pajisjeve farmaceutike, bioteknologjike dhe mjekësore. E themeluar në vitin 2001, Grupi ProFarma ka më shumë se 2,000 kolegë në mbarë botën duke ofruar zgjidhje për sfidat komplekse në një mjedis rregullator dinamik. Me misionin për të përmirësuar shëndetin dhe sigurinë e pacientit, ProFarma është e fokusuar në ofrimin e shërbimeve me cilësi më të lartë gjatë gjithë ciklit jetësor të produktit, duke përfshirë shkencat rregullatore, zgjidhje për kërkime klinike, konsultime të shkencës së jetës, farmakovigjilencë dhe shërbime të informacionit mjekësor.

Përveç kësaj, Grupi ProFarma nuk është aktiv në Maqedoni dhe nuk bën asnjë qarkullim në Maqedoni.

Kompanitë e synuara (direkte dhe indirekte) ofrojnë shërbime gjatë zhvillimit klinik të barnave të reja, pajisjeve mjekësore dhe mbulojnë aspekte të ndryshme të procesit të regjistrimit të produkteve mjekësore, pajisjeve mjekësore, shtesa dietike, kozmetikë, biocide dhe mallra të përgjithshme. Shoqëritë e synuara ofrojnë shërbime shtesë pas marketingut dhe/ose farmakovigjilencë klinike (PV) duke krijuar një sistem farmakovigjilence, si dhe shërbime paraprake për pajisjet mjekësore dhe produkte të tjera jo mjekësore.

Shoqëritë e synuara direkt kanë aktualisht 1 person të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut: **KLINRES FARMACIJA d.o.o.** Zagreb - Përfaqësi në Republikën e Maqedonisë Shkup me seli në Arso Mickov nr. 29 Shkup, me aktivitet prioritar 73.20 – hulumtimi i tregut dhe ekzaminimi i opinionit publik.

Shoqëritë e synuara nuk kanë qarkullim në Maqedoni.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e*

rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски